REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.4629 Prot. Maliq, më 27.07.2026

VENDIM
Nr.98, datë 24.07.2026

PËR
"Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë", i ndryshuar"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", neni 29/1, shkronja "a", neni 54, shkronja "ç", ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.05.2023 *"Për klasifikimin e e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendor, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "*Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë",* i ndryshuar, Këshilli Bashkiak Maliq,

VENDOSI:

I. Të miratoj disa shtesa dhe ndryshime në strukturën organizative të Bashkisë Maliq si më poshtë:

1- Në strukturën e Administratës së Bashkisë Maliq (qëndër), në lidhja nr. 1 të bëhen disa ndryshime si më poshtë:

- Në "*Kabinetin e Kryetarit*", të ndryshohet emërtimi dhe paga për pozicionin e punës "***Këshilltar i Kryetarit***", dhe të bëhet: emërtimi i pozicionit "***Këshilltar i Kryetarit me kohë të pjesshme***", Klasa "Pika 9/10", paga për pozicion bëhet në masën **50.000** (*pesëdhjetë mijë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë;

- Në "*Drejtorinë e të Ardhurave*", të ndryshohet paga për pozicionin e punës "***Nëpunës Inspektor Tatimor Pojan***", me nr. rendor 26 në këtë drejtori, Klasa IV-3, me pagë grupi nga 10-14.000, paga për pozicion në masën **55.000** (*pesëdhjetë e pesë mijë*) lekë dhe shtesë 0.6-1% për vjetërsi në punë.

2- Në strukturën e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, në lidhja nr. 2 të bëhen disa ndryshime si më poshtë:

- "Sektori i Politikave Sociale" ndryshon emërtim dhe bëhet "Sektori i Politikave Sociale dhe Diasporës".

- Pozicioni "Punonjës Social + Arsimi" në "Sektorin e Politikave Sociale dhe Diasporës", ndryshon emërtim dhe bëhet "Punonjës Social + Diasporës".

3- Në strukturën e Sektorit të Bujqësisë dhe Ushqimit, në lidhja nr. 3 të bëhet një ndryshim si më poshtë:

- Në "*Zyrën Bujqësisë*", të ndryshohet paga për pozicionin e punës "***Nëpunës Zyre/Statistikë***", Klasa IV-3, me pagë grupi nga 10-14.000, paga për pozicion në masën **65.000** (*gjashtëdhjetë e pesë mijë*) lekë dhe shtesë 0.6-1% për vjetërsi në punë.

4- Në strukturën e Drejtorisë së Kulturës, në lidhja nr. 4 të bëhet një shtesë dhe ndryshim si më poshtë:

- Në "*Sektori Mbështetës*", të shtohet pozicioni i punës "***Teknik ndriçimi + audio***", me kod (*3521.14*), Klasa "Pika 11", paga për pozicion në masën **57.000** (*pesëdhjetë e shtatë mijë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë.

- Në "*Sektorin e Histologji dhe Librit*", të ndryshohet paga për pozicionin e punës "***Nëpunës informacioni, Biletashitës***", Klasa "Pika 11", paga për pozicion në masën **55.000** (*pesëdhjetë e pesë mijë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë.

5- Në strukturën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në lidhja nr. 5 të bëhet një shtesë dhe ndryshim si më poshtë:

- Në "*Sektorin e Shërbimeve Nj. Ad. Pojan*", të shtohet pozicioni i punës "***Trajner i moshave***", me kod (*3422.16*), Klasa "Pika 11", paga për pozicion në masën **50.000** (*pesëdhjetë mijë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë, me 8 orë pune.

- Në "*Sektorin e Shërbimeve Nj. Ad. Vreshtas*", të ndryshohet paga për pozicionin e punës ***"Punëtor mirëmbajtje Vreshtas"***, me nr. rendor 131 në këtë drejtori, Klasa "Pika 11", paga për pozicion bëhet në masën **50.000** (*pesëdhjetë mijë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë, me 8 orë pune;

6- Në strukturën e Sektorit të Rrugëve Rurale, në lidhja nr. 8 të bëhet një ndryshim si më poshtë:

- Të ndryshohet paga për pozicionin e punës ***"Punëtor krahu mirëmbajtje-Mesmal"***, Klasa "Pika 11", paga për pozicionin bëhet në masën **43.750** (*dyzet e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë, me 7 orë pune.

II. Efektet financiare fillojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe përballohen nga buxheti i miratuar i Bashkisë Maliq për vitin 2026.

III. Për nxjerrjen e urdhrit për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.

Miratuar me 17 vota
Vota Pro 17
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 27.07.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ